



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE
PËR VITIN 2019
TË KOMPANISË RAJONALE TË UJËSJELLËSIT HIDROREGJIONI
JUGOR SH.A PRIZREN**

Prishtinë, gusht 2020

1 RAPORTI I AUDITORIT TË PËRGGJITHSHËM

Për: Ministrin e Ekonomisë dhe Ambientit z. Blerim Kuçi,

Bordin e Drejtorëve të KRU Hidroregjioni Jugor sh.a Prizren znj. Zambeze Guraziu,

Kryeshefin Ekzekutiv z. Zenel Zenelaj,

Zyrtarin Kryesor të Financave dhe Thesarit z. Ibrahim Bajraktari,

Adresa: Rr. "Wesley Clark", 20000, Prizren, Kosovë.

1.1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Kompanisë Rajonale të Ujësjetës Hidroregjioni Jugor sh.a

Ne kemi kryer auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) për vitin 2019 të Kompanisë Rajonale të Ujësjetës Hidroregjioni Jugor sh.a Prizren (me tutje: Kompania), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël.

Opinion i kundërt

Sipas opinionit tonë, për shkak të efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin për "*Bazën për Opinion të Kundërt*", Pasqyrat Financiare të bashkangjitura nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të Kompanisë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, të performancës së saj, si dhe rrjedhës së parasë së gatshme për vitin 2019, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Transaksionet janë kryer në pajtim me rregullat dhe rregulloret financiare, të aplikueshme për ndërmarrjet publike.

Baza për opinion të kundërt

1. Sipas Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit (SNK) 16, rivlerësimi i pasurisë jo qarkulluese kërkohet të bëhet njëherë në tre deri pesë vite, që të sigurohet se vlera kontabël (neto) e aktivitetit nuk ndryshon materialisht nga ajo që do të përcaktohet nëse do të përdorej vlera e drejtë në fund të periudhës raportuese.

Vlera e pasurive jo qarkulluese (toka, objekte ndërtimore, pajisje & makineri, vegla & inventar, mjete transportuese dhe pasuritë të paprekshme) sipas PFV ishte 19,239,802€ për të cilat kompania nuk kishte bërë rivlerësimin e tyre që nga viti 2007. Kompania kishte kontraktuar një kompani të licencuar për vlerësimin e pasurive më 30.01.2020, mirëpo raportin përfundimtarë të vlerësimit të pasurive e kishte pranuar në qershor të vitit 2020 dhe rezultatet e vlerësimit nuk kishte arritur t'i inkorporoj në pasqyrën e pozitës financiare dhe pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet. Megjithatë në shpalosjet e PFV-ve të vitit 2019 kishte prezantuar faktin që ka pranuar raportin e rivlerësimit të pasurive.

2. Sipas SNK 1, pasqyrat financiare duhet të përgatiten sipas parimit aktual. Sipas këtij parimi, të hyrat e shtyra janë të hyra të arkëtuara në avancë, dhe paraqesin detyrime që ka ndërmarrja për të kryer shërbimet në të ardhmen, për shkak të shumave monetare të arkëtuara paraprakisht prej kompanisë. Kështu që, në momentin e marrjes së këtyre mjeteve monetare, duke zbatuar parimin e përputhjes së të ardhurave me shpenzimet e kryera për to, kompania nuk i njeh këto arkëtime si të hyra, pasi shpenzimet për to ende nuk janë kryer. Pra, shtynë njohjen e këtyre të hyrave dhe si pasojë ato do të njihen si detyrime.

Kompania arkëtimet e pranuar në avancë nga klientët e saj (që kishin parapaguar për shërbimet ujit) në shumën 43,148€, nuk i ka njohur si të hyra të shtyra-detyrime, por këtë shumë e kishte zbritur nga llogaritë e arkëtueshme. Veprimet e tilla kanë ndodhur për shkak të pakujdesisë për trajtimin e çështjeve në përputhje me standardet e kontabilitetit të parimit aktual.

3. Korniza konceptuale specifikon se në mënyrë që të plotësojnë objektivat e tyre, pasqyrat financiare përgatiten mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Sipas kësaj baze, efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera njihen kur ato ndodhin (dhe jo kur mjetet monetare ose ekuivalentët e tyre janë arkëtuar ose paguar) dhe ato regjistrohen në regjistrat kontabël dhe raportohen në pasqyrat financiare të periudhave me të cilat ato lidhen.

Kompania tek llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera kishte prezantuar 2,254,890€. Me datë 31.08.2017 kompania në pajtim me ligjin nr. 05/L-043 për falje të borxheve publike kishte nënshkruar një kontratë me Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK) për pagesën e borxhit për shfrytëzimin e energjisë elektrike për 12 njehsorë. Sipas kësaj kontrate borxhi për periudhën para 31.12.2008 do të falej (që ishte 1,188,868€) me kushtin që borxhi i krijuar pas asaj datë të paguhej (që ishte 300,907€), nëse kompania i përmbush kushtet e nenit 3 të kësaj kontrate¹. Kompania kishte dështuar në përmbushjen e kushteve të marrëveshjes dhe si rrjedhojë e kësaj, shuma e paraparë në këtë kontratë nuk do t'i falet kompanisë. Si rezultat i kësaj marrëveshje është krijuar një detyrim, të cilin kompania nuk e kishte njohur në librat kontabël i cili ishte për njehsorin "DPZ 9023798 lokacioni Zhur" në vlerë 274,592€. Gjithashtu, saldo fillestare e llogarive të pagueshme nuk ishte bartur saktë pasi që ishte nënvlerësuar për 26,395€.

4. Sipas Ligjit nr. 06/L-032 për kontabilitet raportim financiar dhe auditim, neni 11.4 libri kryesor është regjistër kronologjik kontabël i cili përdoret për të mbajtur gjurmët e transaksioneve financiare. Transaksionet kategorizohen dhe përmbledhen në llogaritë e Librit Kryesor. Llogaria është regjistër i veçantë për secilin lloj të pasurive, detyrimeve, kapitalit, të ardhurave dhe shpenzimeve dhe zërave jashtë bilancit të gjendjes. Llogaritë e librit kryesor përfshijnë të gjitha llogaritë e planit kontabël të njësisë ekonomike.

Llogaria "Rezultatet e bartura" në fund të vitit 2019 sipas shënimeve kontabël kishte një saldo debitore prej (4,400,784€). Kompania në vitin 2019 kishte bërë mbylljen e kontove

¹ Kontrata për pagesën e borxhit, Neni 3, në rastet kur përfituesi shkakton tri vonesa të njëpasnjëshme lidhur me pagesat sipas programit, marrëveshja shkëputet dhe pjesa e paguar e borxhit, nëse ka, fshihet dhe pjesa e mbetur e borxhit i rikthehet, përfshirë këtu edhe gjitha ndëshkimet.

duke i kredituar për 2,389,552€ zërat financiar (Llogaria e arkëtueshme, Arka, Pasuri) të viteve të mëhershme tek kjo konto. Kjo ka ndikuar edhe në zvogëlimin e saldos fillestare të provizionimit, dhe ka bërë që edhe llogaritë e arkëtueshme të prezantuara të pësojnë rritje krahasuar me vitin e kaluar.

Për më tepër, tek zëri i fitimeve/humbjeve të mbajtura kishte prezantuar vetëm fitimet e vitit në vlerë 14,410€ e jo edhe ato të akumuluar nga periudhat paraprake në vlerë (4,400,784€), duke bërë që edhe rezervat tjera të nënvlerësohen për të njëjtën vlerë. Kjo kishte ndodhur për shkak që kompania nuk i kishte bartur saktë shënimet e kontabilitetit në PVF.

5. Sipas SNK 1, një paketë e plotë e pasqyrave financiare ndër të tjera duhet të përmbajë informacione krahasuese të periudhave paraardhëse.

Kompania në pasqyrën e pozitës financiare tek fitimet e mbajtura nuk kishte prezantuar edhe të dhënat për fitimet e mbajtura për vitin 2018 që janë të dhëna krahasuese për vitin 2019.

6. Sipas SNK 1, një paketë e plotë e pasqyrave financiare duhet të përmbajë edhe pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet për periudhën raportuese.

Kompania kishte hartuar pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, mirëpo tek ndarja e rezervave kishte prezantuar vlerën 2,389,552€ e cila nuk kishte të bënte me rezerva, por kishte të bënte me mbylljen e kontove të zërave financiar (Llogaria e arkëtueshme, Arka, Pasuri) të viteve të mëhershme. Kjo kishte ndodhur në mungesë të monitorimit adekuat gjatë bartjes së të dhënave nga sistemi i vjetër tek sistemi i ri kontabilitetit.

7. Sipas SNK 7, pasqyra e rrjedhës së parasë raporton lëvizjen e parasë gjatë periudhës duke i klasifikuar në aktivitete operative, investuese dhe financuese.

Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative, investuese dhe financuese nuk paraqesin pamje të drejtë. Kompania tek aktivitetet operative për rregullimet e zërave jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave kishte prezantuar diferencën në mes të viteve të investimeve në vijim dhe investimeve afatgjata. Po ashtu, në aktivitetin investues dhe financues kishte prezantuar edhe zëra të cilët nuk kishin të bënin me hyrje apo dalje të parasë duke shkaktuar pasaktësi nëpër aktivitetet e rrjedhës së parasë. Kjo kishte ndodhë për shkak të kontrolleve të brendshme jo adekuate.

8. Sipas SNK 1, shënimet shpjeguese duhet të paraqiten në mënyrë sistematike, për sa kohë që kjo është e mundur. Çdo zë duhet të referohet në mënyrë të kryqëzuar në pasqyrën e pozitës financiar, në pasqyrën e të ardhurave, në pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe në pasqyrën e rrjedhës së parasë. Mangësitë e identifikuar tek shënimet shpjeguese ishin:

- Kompania tek Detyrimet e tjera afatgjata, kishte prezantuar të hyrat e shtyra (grantet) në vlerë 5,247,168€, për të cilat nuk ishte dhënë asnjë informacion në lidhje me politikat e zbatuara kontabël, natyrën dhe madhësinë e granteve, dhe nëse këto grante kanë kushte specifike që duhet të plotësohen; dhe
- Shpalosjet e bëra për fitimet e mbajtura dhe rezervat nuk prezantohen njëjtë si në pasqyrën e pozitës financiare.

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA-t). Përgjegjësitë tona në bazë të këtyre standardeve përshkruhen më tej në pjesën e raportit "Përgjegjësitë e auditorit të përgjithshëm për auditimin e Pasqyrave Financiare". Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe me kërkesat e tjera të rëndësishme për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike dhe Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga Kompania Rajonale e Ujësjellësit Hidroregjioni Jugor sh.a Prizren. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion.

Përgjegjësitë e menaxhmentit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë gjithashtu zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime), dhe Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Menaxhmenti është po ashtu përgjegjës për kryerjen e transaksioneve financiare në pajtim me kornizën e aplikueshme ligjore.

Bordi i Drejtorëve është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme se Pasqyrat Financiare janë në tërësi të lira nga keqdeklarimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe kështu të nxjerrim një raport të auditorit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është niveli i lartë sigurie, por nuk garanton se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdoherë keqdeklarimet materiale që ekzistojnë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, me arsye pritet që të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre Pasqyrave Financiare.

Si pjesë e auditimit, në përputhje me SNISA-t, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticism të profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keqdeklarimit material të Pasqyrave Financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit konform atyre rreziqeve, si dhe sigurojmë dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një keqdeklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për keqdeklarimin

që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulimin, falsifikimin, lëshime të qëllimshme, keqpërfaqësime apo anashkalimin e kontrollit të brendshëm.

- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo me qëllim të shprehjes së opinionit për efikasitet të kontrollit të brendshëm të Kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura kontabël dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim nëse baza e vijimësisë së kontabilitetit është e përshtatshme për përdorim nga menaxhmenti, bazuar në provat e siguruara të auditimit, nëse ekziston pasiguria materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të hedhin dyshime të rëndësishme në aftësinë e kompanisë, për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Nëse konkludojmë se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet përkatëse në Pasqyrat Financiare ose, nëse zbulimet e tilla janë të papërshtatshme ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona bazohen në provat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Sidoqoftë, ngjarjet apo kushtet e ardhshme mund të bëjnë që NP-ja të pushojë së vazhduari sipas parimit të vijimësisë.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e Pasqyrave Financiare, përfshirë edhe shpalosjet, për t'u siguruar se Pasqyrat Financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Ne, gjithashtu i ofrojmë menaxhmentit deklaratën që ne i kemi zbatuar kërkesat përkatëse etike lidhur me pavarësinë, dhe iu komunikojmë atyre të gjitha marrëdhëniet dhe çështjet e tjera që në mënyrë të arsyeshme mund të mendohet se vënë në dyshim pavarësinë tonë, si dhe masat mbrojtëse, aty ku është e zbatueshme. Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Ne i përshkruajmë këto çështje në raportin e auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe Rekomandimet

Ne kemi kryer auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore të Hidroregjionit Jugor për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit si dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të na mundësuar dhënien e opinionit për Pasqyrat Financiare Vjetore.

Lëndë të auditimit kanë qenë edhe efektiviteti i sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe pajtueshmëria me kornizën ligjore dhe rregullative, por jo për qëllime të dhënies së opinionit.

Gjetjet dhe rekomandimet e përfshira në këtë pjesë kanë për qëllim përmirësimin e raportimit financiar dhe evitimin e dobësive në sistemin e kontrollit të brendshëm. Megjithatë, çështjet e ngritura në këtë raport nuk mund të konsiderohen si një pasqyrim i plotë i të gjitha dobësive që ekzistojnë ose të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen.

Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraparak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. Për detajet shih tabelën nr. 1.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të kompanisë gjatë zhvillimit të procesit të auditimit.

2.1 Rekomandimet për opinionin

Rekomandimi B1 Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë se janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme që të regjistrohen shumat e rivlerësimit të pasurive në regjistrat kontabël dhe të prezantohen në pasqyrat financiare vjetore në përputhje me SNK 16.

Rekomandimi B2 Bordi i drejtorëve të sigurojë që regjistrimet e veprimeve që japin efekt në disa periudha kontabël, të bëhen duke u bazuar në parimin aktual, respektivisht paratë e pranuar në avancë të njihen si detyrime ndaj klientëve, përkatësisht të hyra të shtyra dhe vetëm pasi të jetë kryer shërbimi të njihen si të hyra të periudhës.

Rekomandimi A1 Bordi i drejtorëve të sigurojë, që vlera e detyrimeve prezantohet saktë në PFV si dhe të marrë masat e nevojshme korrigjuese të gabimeve në lidhje me detyrimet në të dhënat kontabël.

Rekomandimi A2 Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë që regjistrimet apo korrigjimet e transaksioneve financiare në librin kryesor të bëhen sipas planit kontabël duke prezantuar të dhënat të sakta të cilat janë në harmoni me shënimet kontabël. Për më tepër, të mos prezantohen shumat e dy zërave në pozicionin e vetëm një zëri në PFV.

Rekomandimi A3 Bordi i drejtorëve të sigurojë se Pasqyrat Financiare përmbajnë të dhëna të sakta edhe për periudhën paraprake në mënyrë që zërat financiar dhe shënimet plotësuese në mes të dy viteve të jenë të krahasueshme.

Rekomandimi A4 Bordi i drejtorëve të sigurojë se janë bërë korrigjimet e gabimeve të identifikuar të cilat kanë ndikim tek pasqyra e ndryshimeve në ekuitet, për të prezantuar një pamje të drejtë dhe të vërtetë të kësaj pasqyre.

Rekomandimi B3 Bordi i drejtorëve të sigurojë se janë bërë korrigjimet e gabimeve të cilat kanë ndikim tek pasqyra e rrjedhës së parasë, për të siguruar një pamje të drejtë dhe të vërtetë të lëvizjes së parasë nga secili aktivitet.

Rekomandimi B4 Bordi i drejtorëve të sigurojë që shënimet shpjeguese, përmbajnë parimet bazë që përdoren për hartimin e pasqyrave financiare dhe informacionet mbi përbërjen e zërave të pasqyrave janë dhënë sipas kërkesave të standardeve të kontabilitetit.

Përgjigja e menaxhmentit: Nuk pajtohet. Me gjerësisht shih Shtojcën 1, komentin 1-5

Pozicioni i Auditorit të Përgjithshëm: Kompania me shumë ka dhënë arsyetime dhe përshkrim të situatës së konstatuar nga auditimi se që ka bërë ndonjë kundërshtim. Me gjerësisht shih përgjigjen tek Shtojca 1, komenti 1-5.

2.2 Gjetjet për çështjet e kontabilitetit dhe të pajtueshmërisë (përfshirë auditimin e brendshëm)

Hidroregjioni Jugor gjatë vitit 2018 ka qenë në kontrollë tatimore për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK). Kjo për shkak se Kompania pretendonte se ishte ngarkuar nga ATK me obligime të cilat nuk i takojnë. Kompania kishte parashtruar ankesë në departamentin e ankesave pranë ATK-së mirëpo ankesa ishte refuzuar. Me 20.09.2019 ishte ankuar tek Avokati i Tatimpaguesve i cili kishte kthyer rastin për ri kontrollë. ATK kishte kryer ri-kontrollën dhe me datën 18.03.2020 kishte konstatuar se Hidroregjioni Jugor nuk kishte të drejtë në ankesën e parashtruar dhe se vazhdonte të kishte të njëjtat obligime. Kompania nuk ishte pajtuar me rezultatet e ri kontrollës dhe kishte hap rast kontestimor në gjykatë. Si rrjedhojë e kësaj, zërat dhe shumat që mund të afektohen nga kontesti gjyqësorë ne nuk i kemi komentuar në këtë raport.

Çështja B5 - Pranimet e parave nga klientët e pa identifikuar

Kriteri	Pagesat e borxheve (të arkëtueshmet) nga klientët e Kompanisë duhet të jenë të identifikueshme dhe të njëjtat duhet të regjistrohen në kartelat individuale për tua zbritur borxhin përkatës secilit klient.
Gjetja	Kompania në fund të vitit 2019 në llogarinë e saj posedonte 9,901€ nga pagesat e klientëve pa adresë, pagesat e panjohura në ekstrakt si dhe pagesat që bëhen gabim në llogaritë bankare të kompanisë. Paga kryhen nga klientët e saj, mirëpo për kompaninë mbesin të pa identifikuar për një kohë deri sa të gjendet konsumatori, dhe rrjedhimisht këto mjete mbesin pezull. Kjo për shkak se paratë që pranohen nuk kreditohen direkt llogaritë e arkëtueshme të klientëve përkatës për të zvogëluar borxhin e tyre. Sipas zyrtarëve të ndërmarrjes, kjo ka ndodhur si pasojë e vështirësive në identifikimin e konsumatorëve me rastin e shkarkimit të pagesave nga llogaria bankare.
Ndikimi	Mos identifikimi i klientëve të cilët kanë paguar shërbimin në avans ndikon që kompanisë t'i mbeten llogari të hapura në fund të vitit si dhe llogaritë e arkëtueshme të jenë të mbivlerësuara.
Rekomandimi B5	Bordi i drejtorëve duhet të sigurohet që të bëhet identifikimi i klientëve të cilët kanë paguar në llogaritë bankare të kompanisë, për t'i zbritur borxhet e tyre për shumat e paguara, në mënyrë që llogaritë e arkëtueshme të paraqesin një gjendje reale. Për më tepër, bordi duhet të sigurohet se janë vendosur mekanizma adekuat të kontrolleve të cilat ndihmojnë në identifikimin e klientëve me kohë dhe rrjedhimisht të evitohet krijimi i llogarive të pa identifikuar.

Përgjigjja e menaxhmentit: Nuk pajtohet. Me gjerësisht shih Shtojcën 1, komentin 6

Pozicioni i Auditorit të Përgjithshëm: Kompania me shumë ka dhënë arsyetime dhe përshkrim të situatës së konstatuar nga auditimi se që ka bërë ndonjë kundërshtim. Me gjerësisht shih përgjigjen tek Shtojca 1, komentit 6.

Çështja A5 - Mos llogaritja e drejtë e zhvlerësimit të pasurive

- Kriteri** Sipas SNK 16 pika 50, shuma e amortizueshme e një aktivi do të shpërndahe mbi baza sistematike gjatë jetës së tij të dobishme. Ndërsa në pikën 55 të këtij standardi jepen shpjegime se amortizimi fillon kur aktivi është i disponueshëm për përdorim, d.m.th. kur ai është në vendin dhe kushtet e nevojshme për të, që të ketë mundësi të funksionojë në mënyrën e synuar nga menaxhmenti.
- Gjetja** Nga testimet tona për 100 mostra në kategorinë e pasurive, identifikua se, në 50 asete të blera gjatë vitit 2019, shpenzimet e zhvlerësimit ishin mbivlerësuar për 11,106€, për shkak se ishin aplikuar normat e zhvlerësimit sipas udhëzuesit të ATK-së² e jo sipas SNK-ve. Për më tepër për blerjet e pasurive në muajin maj, zhvlerësimi është llogaritur për tërë vitin. Po ashtu edhe blerjet³ të cilat kanë ndodhur në muajin dhjetor të vitit 2019, shpenzimet e zhvlerësimit janë kalkuluar për gjashtë mujorin e dytë të vitit.
- Ndikimi** Mos llogaritja e drejtë e zhvlerësimit të pasurive për vitin e blerjes ndikon në mbivlerësim të shpenzimeve të zhvlerësimit dhe rrjedhimisht në nënvlerësimin e pasurive në pasqyrën e pozitës financiare.
- Rekomandimi A5** Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë se janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme që në një periudhë sa më të shkurtër të bëhen të gjitha regjistrimet e nevojshme të përlllogaritjes së zhvlerësimit të pasurive në përputhje me kërkesat e standardeve të kontabilitetit.

Përgjigjja e menaxhmentit: Pajtohen

² Sipas Udhëzimit MF-02/2016 për zbatimin e ligjit nr. 05/L-029 për tatimin në të ardhurat e korporatave nenit 17, të pikës 5.5 zhvlerësimi i vitit 1/1, është bërë në lidhje me pasuritë që janë vënë në përdorim/blerë në gjashtëmujorin e parë të vitit.

³ Sipas të njëjtit Udhëzim pikës 5.3 zhvlerësimi i pjesshëm 1/2 është bërë tek pasuritë që janë vënë në përdorim/blerë në gjashtë mujorin e dytë të vitit.

Çështja B6 - Blerjet të shumëfishta të mallrave dhe shërbimeve me para të imët

Kriteri Paratë e imëta shfrytëzohen për blerje të ndryshme me vlera të vogla të cilat paraqiten në raste të paparashikueshme. Ato nuk duhet të shfrytëzohen për shpenzime që mund të bëhen përmes procesit të prokurimit, mallra dhe shërbime me vlerë të kombinuar më shumë se 100€, pagesa të komunalive, pagesa për të punësuarit, etj.

Gjetja Nga 69 pagesat e testuara ne kemi vërejtur se në 21 raste kompania kishte bërë blerje direkte të mallrave dhe shërbimeve me vlera nën 100€ nga Operatorët Ekonomik (OE). Në analizën tonë të kartelës së shpenzimeve të OE që i kemi marrë si mostër kemi vërejtur se kishte fatura të shumëfishta për mallra ose shërbime siç janë: servisime të automjeteve, material higjienik, material elektrik, material administrativ, etj., me të njëjtin OE, ku shumica prej tyre ishin bërë me para të gatshme (petty cash) me vlera nën 100€. Vlera e përgjithshme e pagesave me të njëjtin OE kalon kufirin e caktuar sipas Ligjit të Prokurimit Publik, prandaj Autoriteti Kontraktues ishte dashur të përdorë njërën nga procedurat e prokurimit për t'i realizuar këto blerje.

Këto blerje kanë ndodhur si rezultat i mungesës së planifikimit dhe funksionimit të duhur të kontroleve të brendshme.

Ndikimi Blerja e mallrave dhe shërbimeve përmes parasë së imët me fatura të shumëfishta nën 100€ duke anashkaluar procedurat e prokurimit ndikon që kompania të mos arrij vlerën për paranë e shpenzuar si dhe ndikon në kufizim të konkurrencës.

Rekomandimi B6 Bordi i Drejtoreve duhet të marrë masa për të siguruar se paraja e imët përdoret vetëm për raste të paparashikuara dhe jo për blerjet të cilat mund të bëhen përmes procedurave të prokurimit.

Përgjigjja e menaxhmentit: Nuk pajtohet. Me gjerësisht shih Shtojcën 1, komentin 7.

Pozicioni i Auditorit të Përgjithshëm: Kompania me shumë ka dhënë arsyetime dhe përshkrim të situatës së konstatuar nga auditimi se që ka bërë ndonjë kundërshtim. Me gjerësisht shih përgjigjen tek Shtojca 1, komenti 7.

Nënshkruar nga:



Besnik Osmani

Auditor i Përgjithshëm

Data: 21.08.2020

Zyra Kombëtare e Auditimit


Adresa: Rr. Ahmet Krasniqi, 210

Prishtinë, Kosovë

NAP/ Drejtori/UE



Arvita Zyferi



Enver Bonolli



Liridona Berisha

Shtojca I: Komentet e NP-së në gjetjet e raportit të auditimit

Të gjeturat/ çështjet	Pajtohemi po/jo	Komentet e NP-së në rast të mospajtitimit	Pikëpamjet e ZKA-së
Baza për opinion të kundërt, pika 3	Jo	Rasti i KEK-ut është specifik dhe në procedurë gjyqësor, meqenëse në marrëveshjen ndërmjet KRU Hidroregjioni Jugor dhe Komunës së Prizrenit, të datës 09.06.2011 me numër protokoli 567, për fshatin Zhur, DPZ 9023798, nuk është cekur shuma e obligimit të shpenzimeve të energjisë, për të cilën obligohet kompania, prandaj edhe nuk është regjistruar.	Marrëveshja në mes KEK dhe KRU Hidroregjionit Jugor e lidhur më 31.08.2017 si dhe kartela e furnitorit me nr. identifikues FUR-01052 që ka të bëjë me "DPZ 9023798 lokacioni Zhur". Ky furnitor sipas regjistrave të kontabilitetit kishte të regjistruar borxhin 3,525€ i cili nuk e përmban edhe borxhin në vlerë 274,592€ i cili ishte pjese e marrëveshjes në fjalë. Prandaj ky borxh meqenëse ishte pjese e marrëveshjes ishte dashtë të regjistrohet në kontabilitet dhe të reflektoj edhe në pasqyra financiare të kompanisë.
Baza për opinion të kundërt, pika 4	Jo	Si pasojë e provizionimit të llogarive të arkëtueshme në grupe, të bartura nga viti 2007, vlera e cekur prej 2,389,552 € është bartur te provizionimi dhe janë ngarkuar humbjet e viteve të mëparshme. Me bartjen e të dhënave të kartelave të konsumatoreve nga sistemi i PIANO-së në NAVISION, ka rezultuar se provizionimi i të arkëtueshmeve nuk ka ndodhur edhe në kartelat e konsumatorëve. Prandaj shuma e provizionuar e cekur më lartë është kthyer edhe në grupe të llogarive të arkëtueshme.	Sipas SNK 1 neni 29, Çdo klasë materiale e zërave të ngjashëm duhet të paraqitet veçmas në pasqyrat financiare. Zërat që nuk janë të së njëjtës natyrë ose funksion duhet të paraqiten veçmas me përjashtim të rastit nëse janë jo-materiale. Nga shënimet e kontabilitetit (llogaria 9999 mbyllja e kontove) shihet se vlera 2,389,552€ nuk kishte të dhëna vetëm për llogaritë e arkëtueshme por edhe

		<p>Nuk qëndron se në PFV, janë vetëm fitimet e vitit 2019, por në PFV të vitit 2019 janë të bartura edhe fitimet/humbjet dhe rezervat e tjera nga vitet paraprake.</p> <p>Bazuar në formatin e PFV dy apo edhe më shumë zëra të PK barten në një zë të PFV, prandaj në këtë rast nuk ka alternativ tjetër.</p>	<p>për: arka, banka, pasuri, etj.)</p> <p>Ndërsa tek zëri i fitimeve të mbajtura në PFV e vitit 2019 nuk ishte prezantuar ky zë, por ishte prezantuar vetëm fitimi i vitit.</p>
Baza për opinion të kundërt, pika 5	Jo	<p>Shënimet krahasuese janë bartur rregullisht në PFV sipas kërkesave të zërave të pasqyruar ne PFV duke përfshirë edhe periudhat paraprake - krahasuese, ku si dëshmi e posedoni PFV, në rast se ka vërejtje për pozicione të veçanta, do të duhej që të specifikohet se në cilin pozicion të PFV-ve nuk ka shënime krahasuese dhe mosbarazim.</p>	<p>Në pasqyrën e pozitës financiare në zërin e fitimeve të mbajtura në kolonën e vitit 2018 nuk ishte prezantuar shuma respektive si e dhënë krahasimore mes viteve.</p>
Baza për opinion të kundërt, pika 6	Jo	<p>Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet është e plotësuar dhe e prezentuar me të gjitha shënimet e kërkuara.</p> <p>Shuma 2,389,552 €, e cila është si e "gjetur" ne piken 4. nuk mund të merret si e gjetur edhe në piken 6. Pasi që ajo patjetër reflekton edhe në ekuitet.</p>	<p>Ne i trajtojmë të gjithë pasqyrat dhe secilin zë të prezantuar për të vlerësuar saktësinë e tyre. Andaj në pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, zëri "Ndarja e rezervave" ishte prezantuar me vlerën 2,389,552 e cila nuk kishte të bënte me ndarjen e rezervave, por kjo ishte nga të arkëtueshmet, arka, banka, pasuritë etj.</p>
Baza për opinion të kundërt, pika 7	Jo	<p>Pozicionet e Pasqyrës së rrjedhës së parasë janë si derivate të plotësimit të pasqyrave paraprake si PPF; PA dhe tabelave plotësuese gjatë shpalosjeve.</p> <p>Poashtu e "gjetura" nga pika 4. Ndikon edhe në rrjedhën e parasë, prandaj nuk mund të merret si e gjetur edhe te rrjedha e parasë.</p>	<p>Tek aktivitetet operative në pjesën ku duhet të vendosen rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave është prezantuar diferenca në mes të investimeve në vijim dhe investimeve afatgjata në vlerë 311,590€ ndërsa në këtë pjesë duhet</p>

			<p>të prezantohen vetëm efektet jo në para.</p> <p>Tek aktivitet investuese sipas shënimeve kontabël vlera e blerjeve të pasurive ishte 977,831€ ndërsa është prezantuar 1,177,718€</p> <p>Tek aktivitetet financuese është prezantuar vlera 2,389,554€ kjo vlerë nuk ka të bëjë me aktivitetet financuese.</p>
Çështja B5 - Pranimet e parave nga klientët e pa identifikuar	Jo	<p>Rastet e këtilla, konsiderojmë se nuk janë materiale. Këto ndodhin jo si pasojë e mos angazhimit dhe mos funksionimit të mekanizmave të vendosura nga kompania, por si pasojë e pagesave nga ana e vetë konsumatorëve përmes sistemit bankar. Me angazhimin maksimal të kompanisë në identifikimin e rasteve të tilla, Kompania gjatë vitit 2019 nga 60 raste të tilla me vlerë prej 3,908.81 Euro, ka arritë t'i identifikojë 28 raste të pagesave të konsumatorëve me vlerë prej 3,025.24 euro dhe është bërë korrigjimi, në 5 raste me vlerë prej 180.74 euro, janë identifikuar se janë bërë pagesat gabim në llogaritë e kompanisë dhe pas identifikimit rastet janë kthyer prap në bankë, pra gjatë tërë vitit 2019 kanë mbetur 27 raste me vlerë prej 702.83 euro të cilat me gjithë përpjekjet e kompanisë në bashkëpunim me bankat në të cilat janë bërë pagesa të tilla, nuk kanë mundur të identifikohen. Vlenë për t'u theksuar se krahasuar me periudhat e me hershme rastet e tilla janë zvogëluar dukshëm, por duhet patur të qartë se nuk mund të pretendojmë se raste të tilla nuk do të ketë në të ardhmen.</p>	<p>Për faktin që nuk janë materiale këto raste, kjo gjetje është vendos në këtë pjesë të raportit e jo tek baza për opinion.</p> <p>Meqenëse disa klientë të pa identifikuar kishin paguar ndonjë pjese të borxhit apo parapagim, ato pagesa nuk ju ishte regjistruar në kartelat e tyre individuale meqë nuk janë identifikuar, por e gjithë shuma e këtyre rasteve ishte zbritur vetëm në totalin e llogarisë së arkëtueshme.</p> <p>Sipas shënimeve kontabël, pagesat nga klientët e pa identifikuar në vitin 2018 ishin 9,588€, ndërsa në vitin 2019 ishin 9,901€, pra kishte rritje për 313€ e jo zvogëlim siç e komentoni.</p>

Çështja B6 - Blerje të shumëfishta të mallrave dhe shërbimeve me para të imët	Jo	Duhet theksuar se rastet e tilla nga viti ne vit janë në rënie dhe krahasuar me vitin paraprak blerjet e tilla kanë rënë rreth 50%. Për shkak të specifikave të veprimitarisë së kompanisë është e pa mundur që këto raste të eliminohen në tërësi.	Është e vërtet që krahasuar me vitin paraprak ka zvogëlim të blerjeve përmes parasë se imët, por ato blerje të cilat përsëriten me shpesh duhet të behën përmes procedurave të prokurimit.
--	----	---	---

Shtojca II: Statusi i zbatimit të rekomandimeve të vitit(eve) paraprak(e)

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2018 të KRU Hidroregjioni Jugor ka rezultuar në 12 rekomandime kryesore. Kompania kishte përgatitur një Plan Veprimi ku është paraqitur mënyra e zbatimit të rekomandimeve të marra.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, katër (4) rekomandime janë zbatuar dhe tetë (8) nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Tabelën 1.

Tabela 1. Përmbledhja e rekomandimeve për vitin 2018 dhe vitin 2019

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se rivlerësimi i pasurisë jo qarkulluese kryhet së paku njëherë në 3 deri 5 vite dhe në PFV-të e kompanisë paraqitet vlera e drejtë e pasurive në përputhje me SNK 16.	Kompania kishte bërë rivlerësimin e pasurisë në vitin 2020. Në PFV të vitit 2019 nuk ishin prezantuar ndryshimet.	Rekomandimi pa zbatuar.
2	PFV	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që janë bërë korrigjimet e nevojshme, që pasqyrat financiare të përgatiten dhe paraqiten në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.	Gjatë auditimit kemi identifikuar që ishin bërë korrigjimet e nevojshme për rekomandimin e vitit të kaluar.	Rekomandimi zbatuar.
3	PFV	Kryesuesi i Bordit të sigurojë se zërat përbërës të pasqyrës së rrjedhës së parasë janë prezantuar drejtë nëpër aktivitetet përkatëse operative, investuese dhe financuese.	Edhe këtë vit ka gabime në Pasqyrën e Rrjedhës së Parasë.	Rekomandimi pa zbatuar.
4	PFV	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë bërë të gjitha veprimet për forcimin e kontrolleve të brendshme që të bëhet harmonizimi i duhur i shënimeve kontabël me PFV-të e kompanisë. Gjithashtu të siguroj se letër konfirmimet janë përcjellë të klientët përkatës.	Gjatë auditimit nuk kemi hasur parregullsi të njëjtë me vitin e kaluar.	Rekomandimi zbatuar.
5	PFV	Kryesuesi i Bordit të sigurojë se llogaritë e pagueshme prezantohen me vlerën e tyre reale në mënyrë që të shmangen pagesat e parregullta, ndërsa në rastet ku klientët konfirmojnë vlera tjera nga ato në kontabilitet të	Gjendja e njëjtë me vitin e kaluar.	Rekomandimi pa zbatuar.

		kompanisë të ndërmerren veprimet e nevojshme për harmonizimin e tyre.		
6	PFV	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet të cilat kanë ndikuar tek dhënia e Opinionit të Kundërt dhe do të merren veprimet e nevojshme për eliminimin e tyre. Gjithashtu, kryesuesi i bordit duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2019 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmentin, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe në fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Nënshkrimi i pasqyrave nga KE dhe ZKFTH, nuk duhet të bëhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme para se të njëjtat t'i dorëzohen BD-së.	Edhe këtë vit janë identifikuar parregullsi tek PFV.	Rekomandimi pa zbatuar.
7	Pasqyra e pozitës financiare	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që korrigjimet e efekteve nga periudhat paraprake të reflektohen edhe në kolonën e vitit paraardhës e jo vetëm në atë të vitit raportues. Gjithashtu të shpalosen në shënimet shpjeguese të pasqyrave arsyet dhe efektet e korrigjimit.	Kompania kishte bërë korrigjimet e nevojshme.	Rekomandimi pa zbatuar.
8	Pasqyra e pozitës financiare	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurohet që zyrtarët përgjegjës të bëjnë njohjen e të hyrave pas kryerjes së shërbimeve ndaj klientëve, ndërsa paratë e pranuar në avancë njihen si detyrime ndaj klientëve, përkatësisht të hyra të shtyra.	Edhe këtë vit kompania nuk kishte njohur avancet e pranuar si të hyra të shtyra.	Rekomandimi pa zbatuar.
9	Pasqyra e pozitës financiare	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurohet që të bëhet identifikimi i klientëve të cilët kanë paguar në llogaritë bankare të kompanisë, për t'i zbritur borxhet e tyre për shumat e paguara, në mënyrë që llogaritë e arkëtueshme të paraqesin një gjendje reale. Për më tepër, kryesuesi duhet të sigurohet se janë vendosur mekanizma adekuat të kontroleve të cilat ndihmojnë në identifikimin e klientëve me kohë dhe rrjedhimisht evitohet krijimi i llogarive të pa identifikuar.	Në shënimet kontabël edhe këtë vit kishte pagesa nga klientët e pa identifikuar.	Rekomandimi pa zbatuar.
10	Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë marrë të gjitha veprimet për forcimin e kontroleve të brendshme për të bërë një vlerësim dhe planifikim të nevojave të kompanisë dhe artikujt e ngjashëm të grupohen dhe të përdoren procedurat e prokurimit sipas	Edhe këtë vit kemi hasur në parregullsi të kësaj natyre.	Rekomandimi pa zbatuar.

		kërkesave të LPP-së, duke shmangur ndarjen e blerjeve të njëjta.		
11	Trajtimi i shënimeve shpjeguese	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se gjatë hartimit të PFV-ve, shënimet shpjeguese do të prezantojnë të gjitha informacionet e detajuara, të plota dhe të sakta për secilin zë që përmbajnë shuma të grumbulluara në cilëndo pjesë të PFV-ve. Gjithashtu kurdo që bëhet ndonjë korrigjim i periudhave paraardhëse të shpalosen arsyet dhe efektet e korrigjimit dhe kjo të reflektoj edhe në shumat e periudhës krahasuese në PFV.	Gjatë auditimit kemi identifikuar që edhe këtë vit nuk janë bërë shpalosje të mjaftueshme për PFV-të.	Rekomandimi pa zbatuar.
